

Prof. dr. Riad KAHVAXHI

DILEMAT E SIGURISË PËR MOSSHTIMIN E ARMËVE STRATEGJIKE NË LINDJEN E MESME

Rajoni i Lindjes së Mesme ka qenë vazhdimisht një terren lufte për fuqitë e Perëndimit dhe të Lindjes gjatë kohës së Luftës së Ftohtë dhe për pasojë, ajo ka qenë një arenë e hapur, ku të dy fuqitë e mëdha kishin përfaqësuesit e vet që ndesheshin midis tyre.

SHBA, udhëhiqte dhe mbështeste bllokun e vet të përfaqësuar nga Izraeli, kundër bllokut Rus, i cili në atë kohë përfaqësohej nga Egjipti dhe Siria. Luftërat kryesore në atë kohë zhvilloheshin midis Arabisë dhe Izraelit dhe në stadet e mëvonshme lufta midis Iran-Irak. Pas Luftës së Ftohtë, Lindja e Mesme, njëlloj si një pjesë tjetër e botës, pësoi ndryshime dramatike me riorganizimin e aleancave. Megjithatë rajoni mbeti si i mjegullt dhe madje me rrisqe të mëdha të sigurisë, si rezultat i shtimit të armëve strategjike në këtë rajon.

Në erën e re, SHBA u shfaq si një diell dhe superfuqi botërore, ndërsa Rusia dhe vendet Perëndimore vazhduan të kenë një influencë të konsiderueshme në rajon dhe vazhdimisht kjo influencë kishte prirje të ishte në rritje dhe si rezultat i kthimit të luftës së SHBA-së në Afganistan dhe në Irak.

Me anë të këtij materiali do të tregojmë se si politikat e dy superfuqive, Ruisë dhe Perëndimit të udhëhequra nga SHBA, kanë kontribuar në shtimin e shpejtë, për mosstabilitet të qëndrueshëm dhe si rezultat në mos-ndalimin dhe shpërhapjen e Armëve Shpërthyesë e Shkatërruese (ASHSH) në masë dhe për konsolidimin e stabilitetit në rajon.

Për ASHSH, lidhur me kontrollin e regjimit të tyre, fuqitë e mëdha kanë bërë pakt, për të determinuar fuqitë botërore, për të siguruar direkt ose indirekt tek aleatët e tyre kryesorë në kuptimin

e drejtë të politikave për zhvillimin e shpërthimeve të fuqishme të armëve konvencionale, me qëllim që ato vetë, superfuqitë të sigurojnë një dominim strategjik dhe superioritet në zonën e Lindjes së Mesme.

Programi bërthamor i Izraelit

Njëlloj si në rastet e tjera, në të cilat një vend udhëhiqet për të ndërtuar e rritur aftësitë e prodhimit të ASHSH, programi bërthamor i Izraelit nisi nën ombrellën e një programi kërkimor për qëllime paqësore. Nën siglën e programit “Atomi për Paqe”, jo më vonë se në mesin e viteve ‘50 dhe pikërisht në vitet 1956, specialistët e Izraelit filluan të marrin kurse trajnimi në Komisionin Atomik të Energjisë në SHBA, në qendrën e kërkimeve të Laboratorit Kombëtarë në Aragona të shtetit të Oak Ridge.¹

Nën të njëjtin program, Izraeli dhe SHBA nënshkruan në vitin 1957 marrëveshjen e përgjithshme për bashkëpunimin bërthamor për paqen, përfshi në këtë marrëveshje dhe shitjen e reaktorit bërthamor me ujë të lehtë me fuqi 5 MW (megawatt) për Izraelin. Ky reaktor ishte ndërtuar në Nachal Soraq.²

Në të njëjtën kohë, Izraeli kishte bërë lëvizje të shpejta për një traktat të veçantë në zhvillimin e shtimin e aftësive bërthamore në bashkëpunim me Francën. Qeveria franceze që ishte akoma e hidhëruar nga mospasja e lidhjes së ekspeditës ushtarake me Anglinë dhe Izraelin kundër Egjiptit, ishte duke ndihmuar Izraelin të ndërtonte reaktorin “Dimona”.

Londra ishte gjithashtu pjesëtare në ndihmë të Izraelit, në sigurimin e bombës bërthamore. Dokumentet e siguruar nga arkiva kombëtare Britanike tregojnë se, dy vjet më vonë, Britania kishte shitur ujë të rëndë për Izraelin në vitet 1959 dhe 1960, duke i siguruar mbështetje të

mëtejshme dhe duke i dhënë shtysë programit bërthamorë të Izraelit në “Dimona”.³

Në vitin 1956, Anglia bleu nga Norvegjia 20 ton ujë të rëndë. NorAtomi një kompani norvegjeze kishte të drejtën të shiste dhe të blinte ujë të rëndë, ngarkesë të cilën ajo e dërgoi në Izrael. Uji i rëndë u dërgua në dy porcione me nga 10 ton secila: e para, në muajin qershor 1956 dhe ngarkesa e dytë, në vitin 1960. Licenca

për eksportimin ishte siguruar nëpërmjet shtetit norvegjez për shitjen dhe dërgimin e kësaj sasi në drejtim të shtetit izraelit.

Zyrtarët britanikë kurrë nuk pyetën dhe asnjëherë nuk dhanë ndonjë garanci që kjo sasi e ujit të rëndë ishte e siguruar dhe do të përdorej për qëllime paqësore. Britania gjithashtu furnizoi shtetin izraelit me një numër materialesh jetësore (lënda e parë) gjatë viteve 1950–1960, duke u bërë shkaktare në nxitjen e procesit dhe të lejimit të Izraelit për zhvillimin e industrisë së shpërthimeve të armëve bërthamore.

Disa nga këto materiale përfshinin Uranin (235U), Berilin dhe Litiumin, të cilat do të përdroreshin në përgatitjen e mbushjeve bërthamore dhe madje duke krijuar terrenin e përgatitjes së bombës me hidrogjen. Këto informacione janë nxjerrë nga dokumentet jo të klasifikueshme si sekrete, të cilat kanë dalë në kohën e ish-kryeministrit të Britanisë Sir Harold Wilson, madje për këto dokumente nuk ishte në dijeni dhe ministri i Teknologjisë së asaj kohe (1966), Tonny Benn, që këto materiale strategjike do të shiteshin. E gjitha kjo procedure shitje-blerjeje ishte realizuar nga Michael Israel Michaels, një zyrtar i lartë në Ministrinë e Shkencës së asaj periudhe, i cili ka luajtur rol të rëndësishëm në shitje-blerje të kësaj natyre. Michael ishte përfaqësues i Britanisë së Madhe pranë Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (ANEA-s), në Vjenë (Austri) dhe ishte ftuar të kryente inspektimet në shtetin izraelit, në pajisjet e saja bërthamore në vitin 1961.⁴

Në të njëjtën kohë SHBA i kishte kthyer sytë në aktivitetet që po realizoheshin në reaktorin bërthamor “Dimona” dhe më vonë, qeveria amerikane ra dakord që Izraeli të kryente shpërthimin e saj bërthamor, për aq kohë sa programi i saj kishte mbetur akoma jo i shfaqur dukshëm.⁵

SHBA, gjithashtu vuri veton dhe nuk nxori ndonjë nga përpjekjet e saja nëpërmjet agjencive të bordeve ndërkombëtare, të vinte sanksione dhe embargo ndaj shtetit izraelit. Kjo situatë ndodhi në periudhën kur president i SHBA-së ishte Riçard Nikson (Richard Nixon) dhe në këtë kontekst politika amerikane përkrahte dhe nxiste programet e Izraelit në zhvillimin e industrisë bërthamore dhe madje kjo politikë mbeti e pandryshuar për një kohë të gjatë.

Përpjekjet e para si presion ndaj qeverisë së Izraelit që të

ndalonte dhe të mos zhvillonte më tej programin bërthamorë dështuan, pasi u justifikuan me argumentin se ky program do të vlente për zhvillime të vogla të aftësimit të programeve bërthamore për qëllime paqësore. Që nga koha e presidentit Nikson e deri më tani, politika e Uashingtonit ndaj këtyre çështjeve është karakterizuar nga skena dhe politika të ashtuquajtura fluide (të paqëndrueshme). Mbështetja e padyshuar e SHBA-së ndaj Izraelit në këto afro pesë dekadat e fundit ka qenë në format dhe variantet nga më të ndryshmet:⁶

- Duke ndërprerë dhe përfunduar inspektimet e rregullta në reaktorin bërthamor “Dimon” në kohën e presidentit Nikson dhe akoma më pas kësaj kohe.

- Duke siguruar lëndën e parë dhe teknologjinë kompjuterike më të avancuar në kohë.

- Duke refuzuar dhe penguar ushtrimin e presionit ndaj Izraelit në nënshkrimin e marrëveshjes për zhvillimin e armëve bërthamore, ose që të binte dakord me rezolutën e Kombeve të Bashkuara të Këshillit të Sigurimit (UNSC) për këto qëllime.

- Duke fshehur raportet dhe informacionet e mediave lidhur me dy testet e kryera nga Izraeli në Kalahari të Afrikës së Jugut dhe më pas, në testin e dytë në oqeanin Indian.

- Duke siguruar dhe kamufluar llojin e dyfishtë të programeve bërthamore të Izraelit.

- Duke mbështetur pjesërisht dhe në mënyrë indirekte programet bërthamore të Izraelit dhe duke e financuar në miliarda dollarë ekonominë e saj në zhvillimet shkencore.

Rusia edhe gjatë epokës së ish-Bashkimit Sovjetik, ka ndjekur dhe vepruar me shumë kujdes e vëmendje, programet bërthamore të shtetit izraelit. Megjithëse Moska ka ndihmuar disa nga vendet arabe, si p.sh.: Egjiptin dhe Algjerinë për ndërtimin e reaktorëve të vegjël kërkimorë, që funksiononin me ujë të lehtë më shpejt se nga vitet ‘60, megjithatë kjo përkrahje nuk iu ka krijuar mundësinë vendeve aleate arabe të realizonin ndonjëherë shpërthim bërthamor. Moska duhet të ketë zgjedhur vijën e saj, duke i siguruar aleatëve të saj arabë brenda një ombrelle bërthamore për veprim si një tmerr për Izraelin. Një anije sovjetike, gjoja e ngarkuar me mbushje bërthamore, ishte ankoruar në Aleksandri (Egjipt) gjatë Luftës Yom Kippur në vitin 1973.⁷ Anija me mbushje bërthamore për në

Egjipt ishte raportuar dhe menduar si kundërbalancë e aftësive që kishte Izraeli për mbushjet bërthamore.

Ky veprim ishte bërë i ditur nga disa vëzhgues të sigurimit të garancisë midis Bashkimit Sovjetik dhe Egjiptit. Në këtë kohë presidenti i SHBA-së Nikson, vendosi në ushtritë e tij në të gjithë botën alarmin bërthamor, duke nxitur edhe Izraelin të shikonte gjithashtu gatishmërinë për këtë qëllim. Anija ruse u largua nga Aleksandria pas armëpushimit midis Izraelit dhe Egjiptit, ardhur në fakt, më vonë se nëntori i vitit 1973.

Arsenali i armëve kimike të Irakut

Në luftën e viteve 1980-1988 me Iranin, Iraku kishte përdorur në mënyrë intensive armët kimike. Arsenali i tij u rrit proporcionalisht, pavarësisht nga ekzistenca e regjimeve të kontrolluara të eksportit. Më së shumti shkeljet erdhën nga kompanitë e Perëndimit. Megjithëse kjo nuk ishte provuar asnjëherë, prapëseprapë shumë vëzhgues besonin që arsenali kimik i Iranit ishte bërë i mundur nga bashkëpunimi i nënkuptuar i Perëndimit, që ishte në opozitë për regjimin e ri në Teheran dhe dëshironte ta shihte atë të shndërruar. Dyshimet u rritën shumë kur në një krahasim të dalë nga disa përpjekje të dështuara të Irakut për të siguruar materiale të armëve kimike në vitin 1970 ishin bërë shumë të suksesshme nga përpjekjet vetëm në vitet 1980.

Iraku ishte në vartësi të madhe ndaj përdorimit të pajisjeve për zhvillimin e programit të saj në prodhimin e armëve kimike. Ky shtet importonte shumë nga pajisjet dhe materialet e industrisë kimike nën pretekstin e nevojave të tyre për prodhimin e ushqimeve stok, si dhe të pesticideve. Por përpjekjet e saj, në vitet 1975-1976, nuk ishin të suksesshme veçanërisht pasi të dy kompanitë, ajo amerikane **Pflaudler** dhe një kompani e fuqishme e industrisë kimike kineze⁸ krijuan dyshime të qëllimshme ndaj Bagdadit dhe më pas, refuzuan të siguronin asistencën e duhur teknike.

Megjithatë, përpjekjet e Irakut u drejtuan nga Gjermania Perëndimore, ku nga një raport i ministrit të Ekonomisë, Helmut Hussan, thuhej se 25 firma deri në vitet 1990 kishin siguruar teknologjinë e prodhimit të armëve kimike për Bagdadin. Ndër

të parat prej këtyre firmave të Gjermanisë Perëndimore ishte kompania **Karl Kolb**, që i shiti një impiant teknologjik të aftë për prodhimin e gazit *Sarin*, ndërsa kompania tjetër, **Fritze Werner**, i kishte siguruar asistencën teknike. Kompania e **Tregtisë së Ujit** kishte eksportuar pompa të teknologjisë së rëndë dhe kimikate.⁹

Nga ajo kohë, Iraku kishte filluar luftën me Iranin dhe tashmë kishte të gatshme pilat e prodhimit të gazit *CS* (sulfur karboni) dhe *Ipritt*, të prodhuara në kompleksin kimik të **Samarës**. Armët kimike ishin përdorur në një shkallë të kufizuar në dy vitet e para të luftës Iran-Irak. Por kjo ishte intensifikuar dhe nga “vala humane” e Iranit dhe nga ky fakt filloi të tronditet mbrojtja irakiane.

Bagdadi në vitin 1982 shkoi në një valë blerjesh të mëdha, duke rritur aftësitë prodhuese të gazit *Iprit* dhe sigurimin e agjentëve (gazeve) të rinj neuroparalizues.¹⁰

Më herët se viti 1983, pajisjet e armëve kimike të Irakut kishin prodhuar dy nga gazet me efekte nervo-paralizues, ose agjentet G (gazin *Tabun*) dhe gazin *Sarin*, që janë mjaft të njohura për efektet e tyre të shpejta vdekjeprurëse nga njerëzit e ekspozuar ndaj tyre. Pavarësisht këtij fakti, që Iraku kishte vrarë jo më pak se 1200 njerëz deri në fund të vitit 1984 nga përdorimi i këtyre gazeve (armëve) kimike, komuniteti ndërkombëtar nuk mori masa reale kundra Irakut në të tre e gjysmë vitet e para të luftës me Iranin.¹¹ Puna e parë investiguese e vërtetë ndaj Irakut për përdorimin e armëve kimike filloi më vonë se vitet 1984.¹² Kjo ndodhi vetëm kur atje u krye një sulm i madh në qytetin Kurdish (Halabja), në vitin 1988, ku dhe vdiqën më shumë se 4000 njerëz, duke iu kthyer kështu, një reaksioni shumë të madh ndaj Irakut për përdorimin e armëve kimike,¹³ veçanërisht kundrejt popullsisë së pafajshme. Megjithatë, ishte pushtimi i Kuvajtit nga Iraku, që e vuri atë në listën e shteteve mashtruese dhe për këtë arsye, ishte hapur tashmë si shtet i përfshirë në listën e mbajtjes dhe përdorimit të armëve të dëmtimit në masë, përfshirë këtu dhe armët kimike, si dhe përdorimin e tyre ndaj popullsisë civile në luftën Iran-Irak.

Programi bërthamore i Iranit

Perëndimi ka filluar tani një program bërthamor të diskutueshëm, duke u kthyer pas, në vitet '60. SHBA, Franca dhe Gjermania

Perëndimore luajtën një rol direkt në krijimin e reaktorëve kërkimorë dhe më pas, lejuan ndërtimin e reaktorit bërthamor në **Bushehr**. Ishte kompania gjermane Perëndimore e **Bashkimit Kraftwerk (KWU)**, që kishte realizuar një kontratë në ndërtimin e reaktorit bërthamor në Iran, por punimet u ndërpre në të, pasi në vitin 1979 filloi revolucioni islam, i cili shënoi rrëzimin e **Shahut të Iranit**.

Franca dhe SHBA pezulluan të gjitha bashkëpunimet dhe aktivitetet e tyre me një numër të mëparshëm aleatësh strategjik të tyre në Lindjen e Mesme. Prapëseprapë Franca dhe Gjermania Perëndimore u përpoqën edhe pas viteve '80 të përfundonin programet e bashkëpunimit me Iranin. Një ekip i përbërë nga 18 inxhinierë francezë nga **FrameAtom**, inspektuan reaktorin bërthamor në Bushehr për të vlerësuar dëmtimet si pasojë e sulmeve të Irakut dhe për të përcaktuar se çfarë aksionesh do të ndërmerrnin për ta rindërtuar.¹⁴ Përfaqësuesit e kompanisë KWU të Gjermanisë Perëndimore, në vitin 1987 vizituan vendin në Bushehr për të vlerësuar situatën. KWU kishte raportuar rreth vështirësive ligjore për anulimin e kontratës dhe mbi të gjitha, pagesat për blerjen e pajisjeve. Kompania kërkonte nënshkrimin e një marrëveshje të re me një nga kompanitë argjentinase, ENACE dhe të një grupi nga një kompani spanjolle për të kompletuar ndërtimin e reaktorit në Bushehr.¹⁵ Por, SHBA me anë të presionit i ndaloi këto përpjekje.

Përfshirja e Ruisë me programin bërthamorë të Iranit filloi në vitin 1989, kur presidenti iranian, Hashemi Rafsanjani dhe presidenti sovjetik, Mihail Gorbacov, nënshkruan në Moskë marrëveshjen që përfshinte bashkëpunimin në fushën bërthamore.¹⁶ Rusia dhe Irani nënshkruan në vitin 1992 dy marrëveshje, njëra për ndërtimin e një reaktori bërthamor dhe tjetra në bashkëpunimin e përdorimit të energjisë bërthamore për qëllime paqësore. Në marrëveshjet e Moskës u ra dakord për vazhdimësinë e punëve të nisura vite më parë në reaktorin e Bushehr.¹⁷ Rusia mirëmbante aktivitetin e saj bërthamor në bashkëpunim me Iranin, megjithëse ishte një nënshkruese e paktit në moshtimit e armëve bërthamore. Ajo vazhdonte me ndërtimin e reaktorit në Bushehr dhe njëkohësisht, duke i siguruar dy reaktorë bërthamorë të tjerë. Të gjitha këto aktivitete realizoheshin sipas udhëzimeve të Agjencisë

Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (ANEA).

Në vitet 2002–2003, një marrëdhënie e re rreth programit bërthamor të Iranit tërhoqi vëmendjen e komunitetit ndërkombëtar për aktivitetet e papërmbytura nga ana e Teheranit dhe që ishin në kundërshtim me politikat paqësore të ANEA-s. Me ndihmën e babait të programit bërthamorë të Pakistanit, Abdel Kadir Khan, Irani kërkoi (jo më vonë se vitet '90) pajisje dhe projekte për një ciklim të karburantit bërthamor. Irani kishte ndërtuar pajisjet e nevojshme për pasurimin e uranit dhe tashmë procesi i pasurimit të karburantit bërthamor ishte në udhë të mbarë. Perëndimi, veçanërisht SHBA, akuzonte Iranin mbi përpjekjet e prodhimit të armëve bërthamore, ndërsa Teherani në mënyrë të përsëritshme i kishte mohuar këto akuza. Rusia siç duket e kishte mbështetur Iranin, megjithëse komuniteti ndërkombëtar kishte bërë presione ndaj Iranit për t'i kontrolluar programet e pasurimit të uranit dhe për ta bindur me kërkesat e ANEA-s. Megjithatë Moskë vazhdonte normalisht programet e saja të bashkëpunimit bërthamor në linjën e marrëveshjeve të nënshkruara midis këtyre dy shteteve.

Propozimet e ndryshme të bëra nga Evropa e Bashkuar e vendet e saj anëtare dhe nga ana tjetër, gjithashtu, Rusia përpigjej të arrinte një kompromis me Iranin, të gjitha këto tentativa kishin dështuar.

Këto propozimet udhëhiqeshin nga Këshilli i Sigurisë së Kombeve të Bashkuara në imponimin unanimit të vendosjes së sanksioneve ndaj Iranit dhe këto propozime ishin bërë me anë të dy rezolutave të veçanta.

Situata aktuale

Ashpërsimi i kontrolleve të eksportit dhe regjimi i ri i kontrollit kanë mbyllur shtigjet për mosshkrimin e armëve bërthamore për vitet e shkuara. Iraku ishte i vetmi vend energjik kundërshtar ndaj Perëndimit, por ama që e pagoi dhe me një kosto shumë të lartë heqjen e arsenalit të saj për armët e shkatërrimit në masë.

Izraeli mbetet një fuqi bërthamore e padeklaruar dhe Perëndimi vazhdon të luajë rolin e saj në sigurimin e patejdukshmërisë dhe të transparencës ndaj programeve të saja bërthamore. Qeveria izraelite iu kundërvu në maj të vitit 2006 një marrëveshjeje të re të

parashtruar nga SHBA, në Komisionin e Çarmatimit të Kombeve të Bashkuara, që Izraeli të ndalonte prodhimin e materialeve të ndashme për prodhimin e armëve bërthamore. Izraeli zyrtarisht ishte raportuar i shqetësuar që kjo mund të kërcënonte politikën e saj jotransparente bërthamore.¹⁸ Laboratori bërthamor në Francë (GANIL) dhe Izraeli, nënshkruan në maj të vitit 2006, një memorandum mirëkuptimi lidhur me bashkëpunimin në fushën e kërkimit bërthamor dhe ndërtimin e një akseleratori në Qendrën e Kërkimeve Bërthamore, Soreq, në Izrael.¹⁹ Ndërsa për Iranin, kampi i Perëndimit që udhëhiqet nga SHBA, mbetet përcaktuese në ndalimin e regjimit të tanishëm islam në Teheran, në kërkesat për rritjen e aftësive serioze të teknologjisë që bënte të mundur zhvillimin e fuqisë bërthamore.

Rusia është akoma duke u përpjekur të mbajë një politikë të bazuar në kundërshtimin e kërkesave ndaj armëve bërthamore kundrejt Iranit, por në të njëjtën kohë, dëshiron të ndjekë bashkëpunimin dhe biznesin e saj me Teheranin sipas rregullave të përcaktuara nga ANEA-s.

Oferta e Moskës për Iranin që të ketë impiantet e saja të pasurimit të uranit brenda territorit të Rusisë, parashikon që të jetë akoma e përbuzur për tavolinën e bisedimeve. Në bashkëbisedimet e raundit të fundit midis këtyre dy shteteve, një vit më parë, nuk u arrit asnjë lloj marrëveshjeje.²⁰

Mësimet e nxjerra

Politikat për mosshkrimin e armëve të shkatërrimit në masë, gjithashtu, ruajtja e sigurisë globale në Lindjen e Mesme, janë të dyshimta për t'u realizuar në këtë rajon. Por që mosshkrimi i armëve konvencionale të zërë vend dhe të bëhet pjesë e qëndrueshmërisë për këtë rajon, duhet që të jetë vullneti i përbashkët midis Lindjes dhe Perëndimit, për të mos e kundërshtuar dhe për ta siguruar atë. Ndonëse politikën e deklaruar nga të pesë fuqitë e mëdha bërthamore, të cilat kanë projektuar avokatinë e mosshkrimit të armëve bërthamore dhe qëllimin e përfshirjes së regjimit të kontrollit lidhur me to, prapëseprapë politikën e tyre të jashtme dhe nganjëherë ideologjinë e tyre, e bëjnë atë të lehtë për disa zyrtarë të kuq, ose firma, të prishin kontrollin dhe shpesh t'i anashkalojnë

ato. Kjo situatë është e tillë pasi në disa raste kemi pasur një forcë politike, e cila ka disa elementë të korruptuar brenda gjirit të saj.

Problemet e mosshpimit të armëve të dëmtimit në masë në Lindjen e Mesme, shumë shpesh gjenerojnë nga Perëndimi i pavëmendshëm. Ndërsa shtrëngesa e sistemit ekonomik të kontrolluar në ish-Bashkimin Sovjetik e bën atë të pamundur për zyrtarët dhe kompanitë, që eksportojnë teknologjinë bërthamore për në Lindjen e Mesme. Ky nuk është rast që mund të diskutohet për Perëndimin, ku sistemi ekonomik i tregut të lirë me shtigjet e tij lejon akte të prodhimit e të shitjes të këtyre armëve konvencionale. Kjo mundet të jetë e lidhur me gabimet që fuqitë botërore të Lindjes e Perëndimit duhet të punojnë bashkërisht, fuqishëm dhe me transparencë në këtë çështje.

Megjithatë, riprodhimi duhet të jetë i pamundur të përmbahet në rastet e standardit të dyfishtë dhe në këtë rast nënkuptohet Izraeli. Perëndimi në "ngjashmërinë me strucin" në drejtim të arsenalit bërthamor të Izraelit, ka qenë dhe gjithnjë do të jetë një motiv i parë për vendet e Lindjes së Mesme, që dhe ato të realizojnë kërkime në këtë fushë e për të pasur si pronë të tyre arsenalin e armëve të shkatërrimit në masë.

Mësimi i parë vjen nga eksperiencia e prodhimit të armëve kimike që ishte me një kosto mjaft të lartë për vetë Perëndimin dhe për tërë botën, duke paguar për gabimin e lejuar në ndërtimin e aftësive të armëve të shkatërrimit në masë dhe duke i privuar të tjerët që t'i kenë ato. **Khan** nuk ishte rasti i parë në historinë e përfshirjes së një zyrtari të lartë për kalimin e teknologjisë së armëve të dëmtimit në masë për tek një vend tjetër, për para ose për arsye ideologjike. Bota ka mësuar në vitin 2006, që dhe më herët se Khan, në Londër i ashtuquajturit Zoti Mikael ka bërë diçka të njëjtë për Izraelin. Por me rritjen e mentaliteteve ideologjike-politike të njerëzve në mjedisin përreth dhe në veçanti në Lindjen e Mesme, kjo do ta bëjë të paevitueshme marrjen e kapaciteteve të teknologjive bërthamore dhe nga vende të tjera nga Khan ose Michaels të tjerë, duke nxjerrë jashtë regjimit kontrollin e këtij sistemi. Ky veprim do të jetë alogjik në imagjinatën e vendeve në gjendjen e luftës se deklaruar dhe ideologjitë e ndryshme akute dhe që bota duhet t'i rezistojë këtyre përpjekjeve të mëtejshme për zhvillim dhe përhapjen e armëve bërthamore.

Lufta e fuqive midis Perëndimit (SHBA) dhe Ruisë ka kontribuar për mosstabilitet në Lindjen e Mesme gjatë Luftës së Ftohtë. Megjithatë, ndërsa Moska ka aderuar për një politikë të kundërshtimit të armëve konvencionale dhe të zgjedhur për të siguruar një ombrellë bërthamore për disa nga aleatët e saj strategjik, më saktë duke i siguruar atyre vetëm një teknologji bërthamore, fuqitë Perëndimore nuk kanë respektuar plotësisht siç duhet moshtimin e kontrollit ndaj rregullave në fuqi dhe veçanërisht lidhur me luftën dhe konfliktin arabo- izraelit.

E vërteta është e njëjtë, për një shtrirje me Irakun, ku teknologjia kimike ishte lejuar indirekt nëpërmjet kompanive private më mirë se me rrugët dhe rregullat e zyrtarizuara. Problemi i Irakut për shtimin e armëve të dëmtimit në masë është i tepruar, ndërsa Izraeli është në nivelet e atjeshme me miratimin e pëlqimin e Perëndimit. Kjo ka nxitur shtimin e mëtejshëm rajonal të vendeve që kërkojnë të kenë potencialin bërthamorë, kjo është e lidhur me Iranin dhe që është shumë më tepër se rasti i fundit (Iraku), por jo me pak se i pari (Izraeli). Shumë shtete arabe kanë deklaruar në muajt e fundit, që ata kanë vendosur të kenë teknologjitë e tyre bërthamore për qëllime paqësore. Por kjo mundet të jetë vetëm një nisje për diçka më të madhe, veçanërisht në qoftë se Irani shkon drejt prodhimit të armëve bërthamore, ose Izraeli të mos i japë më shtysë politikave të saja për shtim të armëve të dëmtimit në masë. Perëndimi dhe Rusia janë nën detyrimin e rishikimit të politikave të tyre të tashme, si dhe të perspektivës për Lindjen e Mesme, përpara se orteku i shtimit të armëve bërthamore të jetë shumë i madh dhe të mos kontrollohet, sepse kjo sjell një rrezik të madh për mbarë rajonin dhe botën.

Shënim: Materiali i mësipërm u paraqit në trajnimin: **ARW-NATO**, mbajtur në Moskë (Rusi) në datat 24 - 28 prill 2007, nga Prof. dr. **Riad KAHVAXHI**, nga Emiratet e Bashkuara Arabe, i cili është drejtor i përgjithshëm i Institutit për Lindjen e Mesme dhe Analizën Ushtarake në gjirin arabik.

Materiali u përkthye nga anglishtja dhe u paraqit nga **Luan QAFMOLLA**, i cili ishte pjesëmarrës në trajnimin e përmendur.